



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

S T A T U T I N E I N S T I T U T I T A L B A N O L O G J I K

Në bazë të nenit 11 dhe 23.5 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore, nr 04/L-135 të datës 28.03.2013, si dhe në mbështetje të nenit 5 të Ligjit për Institutin Albanologjik të Prishtinës, Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik

Miratoi:

STATUTIN E INSTITUTIT ALBANOLOGJIK

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelimi dhe subjektiviteti juridik

1. Instituti Albanologjik (në vazhdim vetëm Instituti) është institucion i pavarur publik kërkimor-shkencor, i cili veprimtarinë e vazhdon në bazë të nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135 të datës 28.03.2013.
2. Instituti është institucion me rëndësi të veçantë kombëtare e shtetërore.
3. Instituti ka selinë në Prishtinë,
4. Instituti ka cilësinë e personit juridik.
5. Instituti ka vulën e vet me tekstin: “Instituti Albanologjik”, Prishtinë.
6. Instituti ka faqen e vet zyrtare në internet.
7. Instituti ka logon e vet, e cila vihet në vula, në shkresa si dhe në çdo publikim shkencor të Institutit.
8. Instituti është themeluar më 1 qershor 1953, kurse është rithemeluar më 28 shkurt 1967. Data 1 qershor shënohet si dita e Institutit.

9. Instituti organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e vet kërkimore-shkencore në sektorë dhe degë, si njësi të tjera pune- organizative, e në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

II. VEPRIMTARIA E INSTITUTIT

Neni 2

1. Veprimtaria e Institutit Albanologjik është publike
2. Veprimtarinë e IA e shtrin në të gjitha viset shqiptare.
3. Veprimtaria e IA është e përqendruar në punën kërkimore-shkencore nga fusha e shkencave albanologjike dhe kulturës shqiptare.
4. Instituti organizon:
 - 4.1. punën kërkimore-shkencore e profesionale dhe studimin e thesarit kulturor, material e shpirtëror të shqiptarëve;
 - 4.2. studimin e gjuhës shqipe, zhvillimin historik dhe zhvillimin e sotëm të saj;
 - 4.3. studimin e letërsisë shqipe, zhvillimin historik dhe zhvillimin e sotëm të saj, duke u nisur nga parimi i vazhdimësisë dhe i njëjtësisë së letërsisë kombëtare;
 - 4.4. studimin e folklorit dhe të kulturës popullore shqiptare në tërësinë e saj;
 - 4.5. studimin e etnomuzikologjisë dhe të muzikologjisë shqiptare;
 - 4.6. studimin e historisë shqiptare;
 - 4.7. studimin e lëndës etnologjike shqiptare;
 - 4.8. studimin e lëndës arkeologjike;

4.9. specializimin dhe ngritjen e kuadrit shkencor;

4.10. organizon dhe kryen edhe detyra të tjera kërkimore shkencore nga fusha e albanologjisë dhe e kulturës shqiptare.

Neni 3 Detyrat e Institutit

1. Instituti ka për detyrë t'i bëjë publike rezultatet e kërkimeve shkencore dhe pasurinë shpirtërore e materiale të shqiptarëve.
2. Instituti ka për detyrë të krijojë kushte për formimin dhe ngritjen e kuadrit të nevojshëm shkencor, brenda dhe jashtë Kosovës me qëllim që t'i zbatojë detyrat kërkimore-shkencore dhe t'i përparojë dhe t'i afirmojë studimet albanologjike.
3. Për realizimin e detyrave të veta Instituti kryen këto punë:
 - 3.1. përgatit, harton dhe realizon projekte të ndryshme kërkimore-shkencore, monografi, revista shkencore, studime dhe punime të tjera të ndryshme në gjuhën shqipe ose në gjuhë të tjera nga fushat që përbëjnë sferën e studimeve të tij;
 - 3.2. vjel e përpunon lëndën gjuhësore, letrare, folklorike, etnomuzikologjike, arkeologjike, historike, etnologjike etj., që ka vlerë për studimet albanologjike, dhe bën klasifikimin dhe sistematizimin profesional të materialit të vjelë;
 - 3.3. publikon rezultatet e punës së vet shkencore nëpërmjet botimeve periodike dhe veprave të veçanta;
 - 3.4. boton përkthime të studimeve të autorëve shqiptarë dhe të autorëve të huaj, veprat e të cilëve janë me interes për albanologjinë;
 - 3.5. regjistron, mbledh dhe studion gjetjet dhe monumentet kulturore, pastaj lëndën arkivore dhe dokumentare e tjera që i konsideron të vlefshme për punë kërkimore-shkencore dhe për kulturën e shqiptarëve në përgjithësi, kërkon dhe ruan ato nëse e sheh të nevojshme sidomos kur janë të pambrojtura ose kur janë në kuadrin e institucioneve të tjera;
 - 3.6. bashkëpunon me institucionet dhe me individët që merren me punë të ngjashme brenda ose jashtë vendit tonë;
 - 3.7. organizon tubime dhe aktivitete të ndryshme shkencore, si: tribuna, tryeza, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese

shkencore që kanë për qëllim shtruarjen, shtjellimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga fusha e shkencave albanologjike;

3.8. organizon punën në bibliotekën e vet të specializuar albanologjike, duke mbledhur edhe materiale të tjera dokumentare, të cilat ua ofron për shfrytëzim individëve dhe institucioneve të interesuara;

3.9. organizon punën në arkivin shkencor duke mbledhur, rregulluar, përpunuar dhe duke ruajtur lëndën arkivore të mbledhur në terren;

3.10. zhvillon forma të ndryshme të popullarizimit të punës së vet shkencore, duke organizuar dhe duke nxitur interesim për fushat që studion, për punët e Institutit dhe për rezultatet e arritura;

3.11. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë statut.

III. ORGANIZIMI I PUNËVE NË INSTITUT

IV.

Neni 4

Puna kërkimore-shkencore dhe profesionale-administrative

Veprimtaria themelore e Institutit zhvillohet nëpërmes punës kërkimore-shkencore të punonjësve shkencorë të Institutit, të ngritjes së tyre shkencore, si dhe nëpërmjet punëve të përgjithshme (administrative, profesionale, financiare e teknike)

Neni 5

Sektorët e Institutit

1. Veprimtaria e Institutit është e organizuar dhe zhvillohet në dy sektorë:

- 1.1. sektori shkencor dhe
- 1.2. sektori i përgjithshëm

Neni 6

Sektori shkencor

2. Sektori shkencor është njësi më e gjerë kërkimore - shkencore në kuadër të së cilës zhvillohet tërë veprimtaria kërkimore-shkencore e Institutit.
3. Në kuadër të Sektorit Shkencor përfshihen të gjithë punonjësit shkencorë dhe hulumtues të Institutit, që kanë tituj kërkimorë-shkencorë: këshilltar shkencor, bashkëpunëtorë të lartë shkencorë, bashkëpunëtorë shkencorë, hulumtues të pavarur shkencorë dhe hulumtues shkencorë.
4. Sektorin shkencor e përbëjnë degët e Institutit si njësi themelore shkencore të Institutit.
5. Punën e sektorit shkencor e udhëheq dhe e organizon sekretari shkencor.
6. Sekretari shkencor zgjidhet nga radha e punonjësve shkencorë, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut.

Neni 7

Degët e Institutit

1. Degët janë njësi themelore shkencore të Institutit nëpërmjet të cilave organizohet puna kërkimore shkencore e Institutit.
2. Instituti përbëhet nga këto degë:
 - 2.1. Dega e Gjuhësisë
 - 2.2. Dega e Letërsisë
 - 2.3. Dega Folklorit
 - 2.4. Dega e Historisë
 - 2.5. Dega e Etnologjisë
3. Në fushëveprimin e degëve bëjnë pjesë shkencat e veçanta albanologjike që përcaktojnë degët e tij.
4. Brenda degëve, për fusha të caktuara shkencore, veprojnë seksionet, si trupa pune të specializuara shkencore të degëve.

Neni 8

Themelimi i degëve

1. Në pajtim me ligjin dhe me këtë statut, IA mund të themelojë degë të reja në sektor.
2. Iniciativën për formimin e degëve të reja mundë ta marrë Këshilli Shkencor, Këshilli Drejtues, degët ose punonjësit shkencorë të Institutit nga fusha përkatëse.

3. Iniciativa për formimin e degëve behët me një arsyetim profesional dhe shkencor.
4. Për t'u formuar një degë e re, në të duhet të jenë të punësuar së paku tre punonjës shkencorë, ndër të cilët njëri prej tyre duhet të ketë titullin bashkëpunëtor shkencor.
5. Vendimin për riorganizimin e Institutit, për formimin ose shuarjen e degëve e merr Këshilli Drejtues i Institutit, në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor të Institutit.
6. Organizimi dhe funksionimi i degëve përcaktohet me rregullore të veçantë për organizimin dhe funksionimin e organeve qeverisëse dhe të njësive të Institutit.

Neni 9
Detyrat e degës

1. Dega i kryen këto detyra:
 - 1.1. Propozon, shefin e degës
 - 1.2. propozon planin e punës së degës dhe raportin e punës së degës,
 - 1.3. propozon planin e veprimtarisë botuese të degës,
 - 1.4. propozon dhe arsyeton temat e sesioneve shkencore nga fusha e saj;
 - 1.5. propozon anëtarët e redaksive të revistave shkencore dhe të botimeve të veçanta, si dhe redaktorët për çështje të ndryshme shkencore dhe të veprimtarisë botuese, në nivel të Institutit;
 - 1.6. zgjedh recensuesit dhe miraton dorëshkrimet për botimin e tyre në bazë të vlerësimit të recensuesve ose të redaksisë së fushës përkatëse;
 - 1.7. angazhon punonjësit shkencorë për zhvillimin e një pjese të studimeve universitare dhe pasuniversitare, në bashkëpunim me institucionet universitare;

- 1.8. harton planin dhe programin për specializimin e kuadrit të ri shkencor;
 - 1.9. propozon anëtarët e komisioneve për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë nga dega e vet;
 - 1.10. organizon tubime shkencore, sesione dhe aktivitete të tjera shkencore,
 - 1.11. inicicion çështje shkencore me rëndësi për shkencat albanologjike;
2. kryen edhe punë të tjera, që janë me interes për realizimin e detyrave të degës.

Neni 10

Shefi i degës

1. Punën e degës e udhëheq dhe e organizon shefi i degës.
2. Shef i degës zgjidhet punonjësi shkencor nga radha e degës së Institutit, i cili e ka titullin shkencor së paku bashkëpunëtor shkencor.
3. Shefi i degës është anëtar i Këshillit Shkencor të Institutit dhe mund të zgjidhet edhe anëtar i Këshillit Drejtues.
4. Shefi i degës nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i Këshillit Shkencor dhe i Këshillit Drejtues të Institutit. Shefi i degës që është edhe anëtar i Këshillit Drejtues, merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Shkencor, për ta përfaqësuar degën, por pa të drejtë vote.
5. Shefi i degës zgjidhet për katër vjet. I njëjti kandidat mund të rizgjidhet vetëm edhe një herë.

Neni 11

Punët e shefit të degës

1. Shefi i degës kryen këto punë:
 - 1.1. udhëheq dhe organizon punën kërkimore-shkencore të degës;
 - 1.2. harton projektin e planit dhe të programit të punës kërkimore- shkencore të degës;

- 1.3. përgjigjet për realizimin me kohë të detyrave të degës , të parapara me plan dhe program të punës;
- 1.4. njofton anëtarët e degës në lidhje me të gjitha çështjet që shqyrtohen në organet qeverisëse të Institutit (plani dhe raporti i punës, plani dhe raporti financiar etj).
- 1.5. bashkërendon punën e grupeve ose të individëve, të cilët janë të inkuadruar në realizimin e projekteve kërkimore-shkencore të degës;
- 1.6. kujdeset për ngritjen profesionale të punonjësve të degës dhe të bashkëpunëtorëve të saj;
- 1.7. përgatit, thërret dhe kryeson mbledhjet e degës dhe kujdeset për mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të degës;
- 1.8. përfaqëson degën në të gjitha organet shkencore, profesionale dhe udhëheqëse të Institutit;
- 1.9. në bashkëpunim me degën ose sipas kërkesës së degës , kontakton me institucionet dhe bashkëpunëtorët brenda dhe jashtë vendit;
- 1.10. kryen edhe punë të tjera nga fushëveprimi i degës .

Neni 12

Titujt shkencorë dhe titujt hulumtues

1. Të punësuarit, që merren me punë kërkimore shkencore në Institut dhe që i plotësojnë kushtet e parapara me ligj, me akte nënligjore dhe me këtë statut, zgjidhen në tituj shkencorë ose në tituj hulumtues.
2. Titujt shkencorë janë: bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor.
3. Titujt hulumtues janë: hulumtues dhe hulumtues i pavarur.
4. Titulli bashkëpunëtor shkencor i përgjigjet titullit shkencor-mësimor asistent profesor; titulli bashkëpunëtor i lartë shkencor i përgjigjet titullit shkencor-mësimor profesor i asocuar; titulli këshilltar shkencor i përgjigjet titullit shkencor-mësimor profesor i rregullt.

5. Titulli hulumtues i përgjigjet titullit asistent i ri; titulli hulumtues i pavarur i përgjigjet titullit asistent.

Neni 13

Zgjedhja në titujt shkencorë

1. Bashkëpunëtor shkencor mund të zgjidhet punonjësi shkencor që ka shkallën e doktorit të shkencave, që ka botuar së paku një vepër shkencore, si dhe së paku një punim shkencor të botuar në revista dhe në publikime të njohura në vend dhe në botë.
2. Bashkëpunëtori shkencor zgjidhet në afatin prej katër vjetësh.
3. Bashkëpunëtor i lartë shkencor zgjidhet punonjësi shkencor që ka mbërritur shkallën shkencore të doktorit të shkencave, që ka botuar së paku dy vepra shkencore, një prej të cilave pas zgjedhjes së fundit dhe që pas zgjedhjes në titullin e mëparshëm ka publikuar së paku tri punime me vlera shkencore në revista dhe në publikime të njohura në vend dhe në botë.
4. Bashkëpunëtori i lartë shkencor zgjidhet në afatin prej katër vjetësh.
5. Këshilltar shkencor zgjidhet punonjësi shkencor që ka marrë titullin doktor i shkencave, që ka botuar së paku tri vepra shkencore, një prej të cilave pas zgjedhjes së fundit; që pas zgjedhjes së fundit, ka botuar pesë punime shkencore në revista e publikime të njohura në vend dhe në botë, të cilat kanë ndikuar pa dyshim në zhvillimin e mendimit shkencor në fushën përkatëse dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë shkencore.

Neni 14

Zgjedhja në titujt hulumtues

1. Hulumtues zgjidhet kandidati me studime përkatëse themelore, me notë mesatare mbi tetë dhe që ka kryer studimet master shkencor; që nuk ka më shumë se 27 vjet, (nëse zgjidhet për herë të parë) dhe që ka publikuar punime profesionale ose shkencore. Hulumtuesit zgjidhen në afatin prej tri vjetësh dhe mund të rizgjidhen në të njëjtin titull vetëm edhe një herë.
2. Hulumtues i pavarur zgjidhet kandidati me shkallë akademike të magjistrorit ose të masterit shkencor, që ka regjistruar studimet e doktoraturës, që ka punime të publikuara në revista shkencore. Hulumtuesi i pavarur zgjidhet në afat prej tri vjetësh. Ai mund të rizgjidhet në të njëjtin titull vetëm edhe një herë.

Neni 15
Konkursi publik

1. Zgjedhja e punonjësve shkencorë dhe e hulumtuesve bëhet në bazë të konkursit publik.
2. Konkursi shpallet në mjetet e informacionit publik dhe është i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Neni 16
Marrja e vendimit për konkurs

1. Vendimin për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe të hulumtuesve e merr Këshilli Shkencor i Institutit, sipas propozimit të degës përkatëse.
2. Vendimi për rizgjedhje shpallet gjashtë muaj para skadimit të afatit të zgjedhjes së punonjësit shkencor ose të hulumtuesit.
3. Kushtet e konkursit për punonjës shkencorë dhe hulumtues duhet të jenë në pajtim me Ligjin, Statutin dhe me aktet e përgjithshme juridike të Institutit.
4. Këshilli Shkencor, me rastin e shpalljes së konkursit, mund të përcaktojë kushte shtesë, me qëllim të specifikimit më të detajuar të profilit shkencor të kandidatëve, si: fusha specifike shkencore, njohja e gjuhëve të huaja ose e një gjuhe specifike, mosha, si dhe kushtet të tjera të veçanta të propozuara nga dega përkatëse.

Neni 17
Komisioni vlerësues

1. Mendimin se kandidati i plotëson kushtet për zgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, e jep komisioni vlerësues, i emëruar nga Këshilli Shkencor i Institutit, në bazë të propozimit të degës përkatëse.
2. Komisioni vlerësues profesional, sipas alinesë 1 të këtij neni, përbëhet prej tre anëtarëve, dy prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushtë profesionale dhe nuk bën të jenë me tituj më të ulët se titulli në të cilin zgjidhet kandidati i propozuar.

Neni 18
Referati i komisionit

1. Referati i komisionit duhet të përmbajë:
 - 1.1. shënimet biobibliografike të kandidatit;
 - 1.2. vlerësimin e punës së tij shkencore, si dhe
 - 1.3. propozimin për zgjedhje.
2. Komisioni vlerësues, me rastin e dhënies së propozimit për zgjedhjen e punonjësit shkencor në titullin shkencor, duhet të ketë parasysh dispozitat ligjore dhe aktet e tjera nënligjore, për vlerësimin dhe poentimin e punës kërkimore-shkencore.
3. Referati, sipas alinesë 1 të këtij neni, vihet në diskutim publik më së paku pesëmbëdhjetë ditë para marrjes së vendimit.
4. Këshilli Shkencor i Institutit, në bazë të mendimit të komisionit vlerësues, merr vendim për zgjedhjen e kandidatit të propozuar në titullin përkatës shkencor ose hulumtues.
5. Procedura e konkursit duhet të përfundojë brenda afatit prej tre muajsh.

Neni 19
Lidhja e marrëdhënies së punës

1. Punonjësit e Institutit lidhin kontratën e punës me Institutin në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Kontrata e punës për punonjësit shkencorë, përveç kushteve të përgjithshme nga marrëdhënia e punës, duhet të përfshijë edhe projektin kërkimor shkencor, në të cilin është i angazhuar, si dhe kohën e përfundimit të tij.

Neni 20
Ndërprerja e Kontratës

1. Kontratën e punës me punonjësit shkencorë, Instituti e ndërpret:

- 1.1 në qoftë se punonjësi shkencor ose hulumtuesi, për shkak se nuk rizgjidhet në titullin e paraparë e humb statusin e punonjësit shkencor ose të hulumtuesit;
 - 1.2 në rast se në bazë të konkursit publik në vend të tij zgjidhet punonjësi tjetër shkencor ose hulumtuesi;
 - 1.3 me kërkesën e punonjësit shkencor ose të hulumtuesit;
 - 1.4 nëse punonjësi shkencor ose hulumtuesi nuk e realizon projektin shkencor sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë;
 - 1.5 në qoftë se punonjësi shkencor ose hulumtuesi bën shkelje të rëndë të detyrave të punës, ose me sjelljet e tij cenon rëndë autoritetin e Institutit;
2. Kontrata e punës me punonjësit e tjerë ndërpritet sipas aktit të marrëdhënies së punës dhe ligjit.
 3. Lidhja dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet punonjësve dhe Institutit, përcaktohen me akt të veçantë të marrëdhënies së punës.

Neni 21

Aftësimi i kuadrit shkencor

1. Instituti, në bazë të planifikimit vjetor për përgatitjen dhe aftësimin e kuadrit të ri shkencor, pranon praktikantë-stazhierë, me qëllim të aftësimit dhe përgatitjen shkencore e profesionale të tyre.
2. Praktikant-stazhier mund të zgjidhet personi me studime përkatëse themelore, me notë mesatare mbi tetë.
3. Praktikanti-stazhieri zgjidhet për një vit, me mundësi të vazhdimit të kontratës edhe për një vit tjetër.
4. Gjatë periudhës së kryerjes së stazhit, praktikantët do të angazhohen në projektet kërkimore të degës përkatëse, për të cilët do të përkujdeset shefi i degës ose punonjësi shkencor i degës - udhëheqësi i projektit;
5. Procedura e pranimit të praktikantëve-stazhierëve zhvillohet njësoj sikur për zgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe të hulumtuesve.

Neni 22
Publikimi i të dhënave

1. Instituti ka për detyrë t'i publikojë në faqen e tij të internetit ose në ndonjë mënyrë tjetër t'i vërë në dispozicion të publikut të gjitha aktet normative dhe informatat relevante që kanë të bëjnë me Institutin, si më poshtë:
 - 1.1. ligjin, statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme;
 - 1.2. strategjinë e zhvillimit shkencor të Institutit;
 - 1.3. strukturën e vendeve të punës shkencore dhe të tjera;
 - 1.4. informacionin për anëtarët e organeve qeverisëse, shkencore dhe profesionale të Institutit dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre;
 - 1.5. rregullat dhe procedurat që rregullojnë funksionimin e organeve vendimmarrëse të Institutit;
 - 1.6. rezultatet e kontroleve të brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të saj në përputhje me dokumentet ligjore që rregullojnë sigurimin e cilësisë në fushën e shkencës dhe të arsimit të lartë;
 - 1.7. kodin e etikës;
 - 1.8. dokumentet dhe aktet e të tjera që janë në interes të informimit të opinionit të gjerë.
2. Instituti duhet të publikojë në faqen e tij të internetit edhe këto informacione:
 - 2.1. raportin mbi ecurinë e aktiviteteve dhe projekteve kërkimore-shkencore;
 - 2.2. marrëveshjet e veçanta programore të lidhura me MASHT-in.
 - 2.3. dokumentin mbi kategorinë e Institutit në përputhje me vendimin e miratuar nga MASHT.
 - 2.4. listën e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm;

2.5. informacione të tjera që dalin nga aktet e përgjithshme dhe nga strategjia zhvillimore e Institutit.

Neni 23
Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal i qeverisjes së Institutit.
2. Këshilli Drejtues përbëhet prej 5 anëtarëve.
3. Tre anëtarë të Këshillit Drejtues caktohen nga radha e udhëheqësve të degëve të Institutit, të cilët i cakton Këshilli Shkencor i Institutit, ndërkaq dy anëtarë të tjerë, që kanë tituj shkencorë, emërohen nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
4. Mbi bazën e funksionit, anëtarë të Këshillit Drejtues janë drejtori i Institutit dhe sekretari shkencor.
5. Këshillin Drejtues e udhëheq drejtori i Institutit.
6. Nëse për shkaqe të arsyeshme drejtori nuk mund të marrë pjesë në mbledhje ose në rend dite shqyrtohen çështje që paraqesin konflikt interesi, mbledhjen e udhëheq njëri nga anëtarët e Këshillit, i cili caktohet me shumicë të votave të anëtarëve prezentë të Këshillit.
7. Këshilli Drejtues:
 - 7.1. miraton Statutin si dhe aktet normative të Institutit;
 - 7.2. ndërmerr masa për organizimin dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Institut;
 - 7.3. miraton planin e punës shkencore të Institutit, sipas propozimeve të degëve të Institutit;
 - 7.4. miraton planin e veprimtarisë botuese të Institutit në bazë të propozimit të degëve dhe të Këshillit Shkencor të Institutit;
 - 7.5. miraton Planin financiar të Institutit;
 - 7.6. miraton raportin e punës dhe atë financiar të Institutit;

- 7.7. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e Institutit
 - 7.8. zgjedh dhe shkarkon sekretarin shkencor të Institutit, në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor;
 - 7.9. zgjedh dhe shkarkon sekretarin e Institutit;
 - 7.10. vendos për kërkesat e punëtorëve që lidhen me çështjet e marrëdhënies së punës;
 - 7.11. vendos edhe për çështje të tjera në bazë të këtij statuti.
8. Mënyra e organizimit të punës së Këshillit Drejtues, përcaktohet me rregullore të veçantë.

Neni 25
Këshilli Shkencor

1. Këshilli Shkencor i Institutit është organ shkencor-profesional dhe vendimmarrës në sferën shkencore dhe profesionale të Institutit.
2. Këshilli Shkencor:
 - 2.1. Shqyrton dhe vendos çështjet shkencore dhe profesionale;
 - 2.2. Propozon kandidatët për drejtor të Institutit;
 - 2.3. Cakton komisionet dhe zhvillon procedurën e zgjedhjes në tituj shkencorë dhe në tituj hulumtues;
 - 2.4. Shqyrton dhe propozon planin e punës kërkimore-shkencore dhe të veprimtarisë botuese të Institutit;
 - 2.5. Shqyrton raportin e punës kërkimore-shkencore të Institutit;
 - 2.6. Zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues, nga radha e shefave të degëve,

- 2.7. Propozon sekretarin shkencor të Institutit;
- 2.8. Në bazë të propozimeve të degëve, zgjedh kryeredaktorët dhe anëtarët e redaksive të revistave dhe të botimeve të veçanta të Institutit;
- 2.9. Kujdeset për aftësimin e kuadrove shkencore dhe profesionale;
- 2.10. Vendos edhe për çështje të tjera që për nga rëndësia e tyre profesionale dhe shkencore, duhet t'i shqyrtojë Këshilli Shkencor.
3. Këshillin Shkencor e përbëjnë të gjithë punonjësit shkencorë të Institutit që kanë tituj shkencorë, së paku bashkëpunëtorë shkencorë.
4. Anëtarët e zgjedhur në Këshillin Drejtues, marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit Shkencor, por nuk kanë të drejtë vote për çështjet që vendosen në Këshillin Drejtues.

Neni 26

Punët e Këshillit Shkencor

1. Këshilli Shkencor punon në mbledhje dhe në komisione, në të cilat duhet të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.
2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
3. Mbledhjet e Këshillit Shkencor i thërret dhe i kryeson drejtori i Institutit.
4. Nëse për shkaqe të arsyeshme drejtori nuk mund të marrë pjesë në mbledhje ose në rend dite shqyrtohen çështje që paraqesin konflikt interesi, mbledhjen e Këshillit e udhëheq sekretari shkencor i Institutit, ose një anëtar tjerë të cilin në mbledhje e cakton Këshilli me shumicë të votave.
5. Në mbledhje mbahet procesverbal, për të cilin përkujdeset sekretari shkencor i Institutit.

6. Për çështjet që nuk janë të përcaktuara me këtë Statut e që kanë të bëjnë me punën e Këshillit, do të përcaktohen me Rregullore të veçantë të punës së Këshillit Shkencor, të cilën e miraton Këshilli.

Neni 26
Drejtori i Institutit

1. Drejtori i Institutit është organ individual i qeverisjes së Institutit.
2. Drejtor zgjidhet personi i cili, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet t'i përmbushë edhe këto kushte të veçanta:
 - 2.1. të jetë doktor i shkencave albanologjike, përkatësisht t'i plotësojë kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor;
 - 2.2. të ketë vepra të botuara me rëndësi të veçantë në degën sektorin përkatëse;
 - 2.3. të ketë njohuri të dëshmuara të problematikës së studimeve albanologjike;
 - 2.4. të ketë përvojë dhe aftësi të dëshmuara në organizimin dhe udhëheqjen e punëve kërkimore - shkencore.
3. Kandidati, me rastin e konkurrimit, duhet të paraqesë projektin për zhvillimin e punës kërkimore – shkencore, si dhe të mirëvajtjes së punëve të tjera në Institut etj.
4. Këshilli Drejtues i Institutit, me rastin e shpalljes së konkursit, mund të caktojë edhe kushte të tjera të veçanta, si fusha me të cilën merret kandidati, etj.

Neni 27
Zgjedhja e drejtorit

1. Drejtori zgjidhet në bazë të konkursit publik, të cilin e shpall Këshilli Drejtues i Institutit, pas njoftimit paraprak të Ministrisë.
2. Këshilli Shkencor cakton Komisionin për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit. Komisioni ka për detyrë të konstatojë se cilët prej kandidatëve, që kanë konkurruar, i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, në pajtim me ligjin dhe me Statutin e Institutit.

3. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve të cilët i cakton Këshilli Shkencor nga radha e punonjësve shkencorë të Institutit. Anëtarë të Komisionit mund të caktohen edhe punonjës nga institucione të tjera të shkencës.
4. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit vlerësimin shkencor e profesional për secilin kandidat të paraqitur, si dhe jep propozimin e vet se cilët prej tyre i plotësojnë më së miri kushtet për t'u zgjedhur drejtor i Institutit.
5. Në mbështetje të këtij vlerësimi, Këshilli Shkencor i Institutit i propozon Këshillit Drejtues të Institutit kandidatët për drejtor të Institutit.
6. Drejtorin e Institutit e zgjedh Këshilli Drejtues i Institutit, në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor të Institutit.
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka të drejtë ta revidojë apo ta anulojë vendimin e Këshillit Drejtues kur konstatohet se janë shkelur dispozitat ligjore për emërimin apo shkarkimin e drejtorit të institutit.
8. Mandati drejtorit është 4 vjet. I njëjti person mund të rizgjidhet në pajtim me ligjin.

Neni 29

Caktimi i ushtruesit të detyrës së drejtorit

1. Në qoftë se drejtori nuk zgjidhet në kohën e duhur, detyrën e drejtorit e kryen ushtruesi i detyrës.
2. Ushtruesin e drejtorit e zgjedh Këshilli Drejtues, nga radha e punonjësve të Institutit, në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor.
3. Ushtruesi i detyrës i ka të gjitha obligimet dhe përgjegjësit e drejtorit.
4. Mandati i ushtruesit të detyrës së drejtorit mund të zgjasë deri në gjashtë muaj.

Neni 29
Detyrat tjera të drejtorit

1. Drejtori, krahas detyrave të përcaktuara me ligj, kryen edhe këto punë:
 - 1.1. Përfaqëson Institutin dhe kujdeset për ligjshmërinë e veprimtarisë së Institutit dhe të organeve të tij;
 - 1.2. Udhëheq veprimtarinë e Institutit dhe ndërmerr masa për realizimin e saj;
 - 1.3. Udhëheq Këshillin Drejtues, si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre,
 - 1.4. Kryeson Këshillin Shkencor,
 - 1.5. Është urdhërues dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar të Institutit;
 - 1.6. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë statut.
 - 1.7. pranon në marrëdhënie pune punëtorët e administratës dhe vendos lidhur me përgjegjësinë e tyre;
2. Drejtori i Institutit, për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe të ligjit.
3. Drejtori së paku një herë në vit i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit raport për punën e tij dhe veprimtarinë e tërësishme të Institutit.
4. Në qoftë se drejtori, për shkaqe të arsyeshme, nuk mund ta ushtrojë detyrën për një periudhë deri në 30 ditë, detyrën e drejtorit e ushtron sekretari shkencor.

Neni 30
Shkarkimi i drejtorit

1. Drejtori shkarkohet nga detyra e caktuar para kalimit të afatit:

- 1.1. nëse Këshilli Drejtues konsideron se nuk i kryen si duhet punët që i janë besuar dhe kur ai me veprimet e tij ndikon negativisht në punën e tërësishme të Institutit;
 - 1.2. nëse shkel rëndë ose shkel vazhdimisht dispozitat, që i përkasin punës së Institutit;
 - 1.3. sipas kërkesës së tij;
 - 1.4. kur i pushon marrëdhënia e punës (për shkak të pensionimit)
 - 1.5. në rastet e tjera të parashikuara me ligj.
2. Iniciativën për shkarkimin e drejtorit mund ta bëjnë: Këshilli Shkencor dhe Këshilli Drejtues.
 3. Vendimin për shkarkim e merr Këshilli Drejtues i Institutit.
 4. Shkarkimi i drejtorit bëhet sipas mënyrës së emërimit të tij.

Neni 31
Sekretari shkencor

1. Sekretari shkencor i Institutit, krahas detyrave të tij të punonjësit shkencor (nga marrëdhënia e punës), kryen edhe këto detyra:
 - 1.1. Bashkërendon punën e sektorit shkencor në bashkëpunim me shefat e degëve;
 - 1.2. Zëvendëson drejtorin nëse për shkaqe të arsyeshme këtë detyrë nuk mund ta ushtrojë drejtori i Institutit;
 - 1.3. kujdeset për veprimtarinë kërkimore shkencore dhe botuese të Institutit;
 - 1.4. përkujdeset për organizimin e tubimeve shkencore, ekspeditave shkencore të punonjësve shkencorë të Institutit si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Institutit;
 - 1.5. përkujdeset për organizimin e përvjetorëve të ndryshëm në Institut;
 - 1.6. kryen edhe punë të tjera nga fushëveprimi i vet.
2. Sekretar shkencor mund të zgjidhet punonjësi shkencor me gradën akademike doktor i shkencave albanologjike, përkatësisht punonjësi që i plotëson kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor shkencor;

3. Sekretarin shkencor e zgjedh Këshilli Drejtues i Institutit, nga radha e punonjësve shkencorë të Institutit, sipas propozimit të Këshillit Shkencor.
4. Sekretari shkencor zgjidhet me mandat për 4 vjet. I njëjti person mund të rizgjidhet.

Neni 32
Sektori i përgjithshëm

1. Instituti e ka Sektorin e përgjithshëm, që kryen punë administrative, profesionale, financiare, teknike etj.
2. Sektorin i përgjithshëm e përbën Shërbimi profesional, administrativ e teknik dhe Shërbimi i financave
3. Stafi profesional, administrativ financiar dhe teknik zgjidhet në bazë të ligjit të punës.
4. Vendimin për pranimin në punë të punonjësve profesionalë, administrativë, financiarë dhe teknikë e merr Këshilli Drejtues, në bazë të propozimit të Komisionit intervistues.
5. Organizimi i punës në Shërbimin e Përgjithshëm përcaktohet me rregullore të veçantë të sistematizimit të vendeve punëve dhe detyrave të punës.

Neni 33
Sekretari i Institutit

1. Punën e Sektorit të Përgjithshëm e organizon dhe e udhëheq sekretari i Institutit.
2. Sekretar i Institutit mund të zgjidhet personi i cili ka kryer fakultetin juridik dhe ka së paku tri vjet përvojë në organizimin e punëve juridike, administrative dhe profesionale.
3. Sekretarin, në bazë të ligjit të shërbyesve civilë, e zgjedh Këshilli Drejtues i Institutit.
4. Sekretari për punën e vet i përgjigjet drejtorit dhe Këshillit Drejtues të Institutit.
5. Sekretari kujdeset, në aspektin administrativ dhe profesional, për realizimin e vendimeve të Këshillit Shkencor dhe të Këshillit Drejtues të Institutit.

Neni 34
Biblioteka e Institutit

1. Instituti ka Bibliotekën e vet, që është njësi profesionale e Institutit.
2. Biblioteka mbledh, rregullon, përpunon, ruan dhe jep në shfrytëzim (intern) fondin e Bibliotekës.
3. Punën e Bibliotekës e udhëheq Këshilli i Bibliotekës, që përbëhet prej tre anëtarësh, me mandat prej 3 vjetësh, të cilin e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli Drejtues i Institutit.
4. Punët profesionale të bibliotekarisë i kryejnë punëtorët profesionalë të Bibliotekës.
5. Organizimi dhe puna e Bibliotekës përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 35
Arkivi Shkencor i Institutit

1. Arkivi Shkencor i Institutit është njësi profesionale e Institutit.
2. Arkivi mbledh, rregullon, përpunon dhe ruan lëndën arkivore të mbledhur në terren, si dhe materiale të tjera me rendësi shkencore për albanologjinë: dorëshkrime të autorëve, punonjës shkencorë të Institutit ose bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilët botojnë në Institut, dorëshkrime të autorëve (shqiptarë dhe të huaj) të periudhave të ndryshme kohore, që trajtojnë çështje të albanologjisë, vepra dhe dorëshkrime të periudhave kohore të cilat, për shkaqe të ndryshme, nuk kanë pasur mundësi të jenë në Arkivin e Institutit si dhe materiale të tjera të rëndësishme për trashëgiminë kulturore të shqiptarëve.
3. Punën e Arkivit e udhëheq Këshilli i Arkivit Shkencor, i përbërë prej tre anëtarësh, me mandat prej 3 vjetësh, të cilin e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli Drejtues i Institutit.
4. Punët profesionale i kryejnë punëtorët profesionalë të Arkivit.
5. Organizimi dhe puna e Arkivit më hollësisht përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 36
Veprimtaria botuese

1. Veprimtaria botuese e Institutit përfshin botimet e rregullta dhe ato të veçanta të Institutit.
2. Botimet e rregullta janë organe të përhershme të Institutit:
 - 2.1. Gjurmime albanologjike:
 - 2.1.1. seria e shkencave filologjike
 - 2.1.2. seria folklor dhe etnologji
 - 2.1.3. seria e shkencave historike
 - 2.2. Recherches albanologique
 - 2.3. Gjuha shqipe
3. Këshilli Shkencor, me propozimin e degëve ose të Këshillit Drejtues, mund t'i shtojë seritë për fusha të caktuara në kuadër të një reviste shkencore, ose të nxjerrë revista të reja, varësisht nga nevojat shkencore.
4. Revistat shkencore të Institutit udhëhiqen nga redaksitë përkatëse.
5. Këshilli Shkencor, në bazë të propozimit të degëve, i zgjedh redaksitë e revistave dhe të botimeve të tjera, numri i të cilave përcaktohet me rregullore të veçantë.
6. Këshilli Shkencor, në bazë të propozimit të degëve, zgjedh edhe redaksitë e botimeve të veçanta, (të tubimeve shkencore, të materialeve etj.) për këto fusha:
 - 6.1. redaksia e gjuhësisë
 - 6.2. redaksia e letërsisë
 - 6.3. redaksia e folklorit
 - 6.4. redaksia e historisë
 - 6.5. redaksia e etnologjisë

7. Për botimin e monografive, dega përkatëse cakton së paku dy recensues, si dhe mund të caktojë edhe redaktorin.
8. Asnjë botim i Institutit nuk mund të botohet pa vlerësimin e recensuesve dhe pa miratimin e këtij vlerësimi nga dega e fushës përkatëse.
9. Redaksitë e organeve të përhershme të Institutit zgjidhen për katër vjet. Ato mund të rizgjidhen.
10. Redaksitë nga pika 6 e këtij neni zgjidhen vetëm për botimin përkatës.
11. Veprimtaria botuese më përafërt përcaktohet me rregullore të veçantë.

Neni 37
Aktivitetet e Institutit

1. Instituti, në kuadër të veprimtarisë së tij, organizon tubime dhe aktivitete të ndryshme shkencore, si: tribuna tryeza, sesione, simpoziume, konferenca dhe kongrese shkencore.
2. Degët e Institutit mund të jenë organizatore të tribunave, të tryezave dhe të sesioneve shkencore.
3. Vendimin për mbajtjen e aktiviteteve shkencore nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni e merr Këshilli Drejtues i Institutit në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor ose të degëve të Institutit.

Neni 38
Plani dhe programi i punës

1. Punonjësit e Institutit kanë për detyrë që në pajtim me bazat e planifikimit shkencor në Kosovë, të hartojnë planin dhe programin e punës.
2. Me planin dhe programin e punës Instituti inkuadrohet në Programin Kombëtar Kërkimor-Shkencor të Kosovës.
3. Instituti miraton planet e programet e punës njëvjeçare, trevjeçare, pesëvjeçare dhe ato afatgjata dhjetëvjeçare, varësisht nga projektet kërkimore shkencore.

4. Plani dhe programi i punës së Institutit përfshin:
 - 4.1. projektet kërkimore – shkencore, sipas fushave;
 - 4.2. lloji i kërkimeve shkencore;
 - 4.3. dinamika, afatet e realizimit dhe objektivat e projektit;
 - 4.4. plani i aftësisimit dhe i ngritjes shkencore dhe profesionale të kuadrit shkencor;
 - 4.5. forma e prezantimit publik dhe i zbatimit të rezultateve kërkimore- shkencore;
 - 4.6. plani i bashkëpunimit me institucionet e tjera kërkimore shkencore, me universitetet, si dhe me institucionet e tjera të arsimit të lartë;
 - 4.7. çështje të tjera të rëndësishme për aktivitetet specifike kërkimore-shkencore të Institutit.
5. Plani dhe programi i punës së Institutit hartohet mbi bazën e planeve të punës, të parapara nga degët e Institutit.
6. Planin dhe programin e punës e miraton Këshilli Drejtues i Institutit, i propozuar nga Këshilli Shkencor.

Neni 39
Programi i punës

1. Programin e punës kërkimore ~ shkencore të Institutit e realizojnë punonjësit shkencorë të Institutit.
2. Punonjësit shkencorë marrin përsipër realizimin e projekteve nga fusha përkatëse, të miratuara nga Institutit.
3. Për ndonjë pjesë të projektit, në rast të mungesës së punonjësve shkencorë nga fusha të specializuara, mund të angazhohen edhe punonjës të tjerë shkencorë, jashtë Institutit.
4. Detyrimet e ndërsjella ndërmjet Institutit dhe punonjësit shkencor për realizimin e projektit shkencor përcaktohen me kontratë.

Neni 40
Veprimtaria financiare

1. Të ardhurat e Institutit janë:
 - 1.1. mjetet për veprimtari të rregullt, të cilat përcaktohen me Buxhetin e Kosovës;
 - 1.2. mjetet që realizohen nga veprimtaria e tij;
 - 1.3. mjetet nga burimet e tjera vetjake dhe të donacioneve;
 - 1.4. burime të tjera të ligjshme.
2. Instituti harton planin e vet financiar, të cilin e miraton Këshilli Drejtues, për të cilin pëlqimin paraprak e jep MASHT-i.
3. Këshilli Drejtues shqyrton, gjatë vitit, raportet financiare të Institutit, për periudha të caktuara kohore, të parapara me ligj të cilat, sipas kërkesës së tyre, u dërgohen organeve dhe institucioneve shtetërore.
4. Realizimi i planit financiar konstatohet me raportin financiar vjetor në fund të vitit, të cilin e miraton Këshilli Drejtues.
5. Mjetet e Institutit përdoren vetëm për dobi të Institutit dhe për qëllime e detyra të përcaktuara me këtë statut.

Neni 41
Mjetet financiare

1. Mjetet financiare për veprimtari të rregullt të Institutit përfshijnë:
 - 1.1. mjetet për projekte shkencore;
 - 1.2. mjetet për pagat e punonjësve të Institutit;
 - 1.3. mjetet për realizimin e programit të punës kërkimore-shkencore të Institutit;

- 1.4. mjetet për shpenzimet materiale dhe administrative të Institutit;
- 1.5. mjetet për veprimtari botuese;
- 1.6. mjetet për tubime shkencore;
- 1.7. mjetet për Bibliotekën dhe Arkivin e Institutit;
- 1.8. mjetet për ekspedita shkencore në terren dhe për hulumtime shkencore në biblioteka dhe arkiva në vend dhe në botën e jashtme;
- 1.9. mjetet për bashkëpunim ndërkombëtar;
- 1.10. mjetet për aftësimin e kuadrit shkencor;
- 1.11. mjetet për pajisje dhe për mirëmbajtjen investuese të ndërtesës dhe të pajisjeve të Institutit.

Neni 42

Dokumentacioni i klasifikuar (Sekreti i punës)

1. Dokumentacioni i klasifikuar (sekret pune) konsiderohen dokumentet dhe shënimet që qasja ose dhënia informacioneve personave të paautorizuar do të dëmtonte veprimtarinë e Institutit përkatësisht do të ishin në kundërshtim me ligjin përkatës mbi qasjen në dokumentet publike ose të ruajtjes së sekretit të punës.
2. Dokumente të klasifikuara konsiderohen:
 - 2.11. Dokumentet të cilat si të tilla i klasifikon drejtori i Institutit;
 - 2.12. Dokumentet të cilat institucioni tjetër publik i klasifikon si sekrete, për të cilat njoftohet Institutit;
 - 2.13. Masat dhe procedurat që do të ndërmerren në rast të rrethanave të jashtëzakonshme;
 - 2.14. Dokumentet që kanë të bëjnë me mbrojtjen;
 - 2.15. Plani i sigurimit fizik dhe teknik të objektit të Institutit;
 - 2.16. Dokumente dhe shënime të tjera që dhënia personave të paautorizuar do të ishte në kundërshtim me interesat e Institutit dhe të organeve shtetërore.

3. Dokumentet dhe shënimet që konsiderohen të klasifikuara (sekret i punës) mund t'ia jep në shfrytëzim personave të autorizuar, vetëm drejtori ose personi tjetër i Institutit, në përputhje me ligjin përkatës.
4. Shkelja e detyrimit të sekretit të punës paraqet shkelje të rëndë të detyrës.
5. Për ruajtjen e sekretit të punës, kujdeset drejtori i Institutit ose personi tjetër i autorizuar.

Neni 43
Pasuria e Institutit

Instituti është titullar i patundshmërisë, sipas fletës poseduese nr. 996 (i ngastrës kadastrale, nr. 7090/19, ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës), i bibliotekës, i koleksioneve shkencore dhe artistike, si dhe i gjësendeve të tjera, të cilat i ka siguruar nëpërmjet blerjes, donacioneve ose në ndonjë mënyrë tjetër, dhe kujdeset në përputhje me ligjin.

Neni 44
Dispozitat shfuqizuese

Ditën që hyn në fuqi ky Statut, shfuqizohet Statuti i mëparshëm i Institutit Albanologjik, nr. 114/8, i datës 3 nëntor 2008.

Neni 45
Dispozitat Kalimtare

1. Instituti harmonizon aktet e përgjithshme juridike me dispozitat e këtij statuti dhe bën organizimin e punës së vet brenda gjashtë muajsh që nga dita e hyrjes së tij në fuqi.
2. Procedurat e zgjedhjes dhe të rizgjedhjes së punonjësve shkencorë, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Statuti, do të përfundojnë sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në çastin e fillimit të procedurës, nëse nuk janë në kundërshtim me ligjin.
3. Përgjegjësit e degëve, kryeredaktorët dhe anëtarët e redaksive të revistave shkencore të Institutit, të zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij Statuti, përfundojnë mandatin e tyre sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në çastin e zgjedhjes së tyre.

Neni 46
Dispozitat e hyrjes në fuqi


Ky Statut do të hyjë në fuqi pasi ta ketë dhënë pëlqimin paraprak MAShT dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit.

Pëlqimi i MAShT, datë: 22 prill 2015; nr. _____

Prof. dr. Arsim Bajrami, ministër



Miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik



kryetar

Datë: 27.4.2015



Nr. 0132/2